

VENDIM
Nr.359, datë 4.5.2011

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE
NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar” dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

- a) në qarkun Tiranë, 492 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 90 844,41 (nëntëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e katër presje dyzet e një) m²;
- b) në qarkun Durrës, 307 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 97 957, 80 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë) m²;
- c) në qarkun Shkodër, 164 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 18 829, 11 (tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e nëntë presje njëmbëdhjetë) m²;
- ç) në qarkun Lezhë, 143 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 51 813, 64 (pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e trembëdhjetë presje gjashtëdhjetë e katër) m²;
- d) në qarkun Berat, 102 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 276, 83 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tetëdhjetë e tre) m²;
- dh) në qarkun Fier, 177 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 47 231, 40 (dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e një presje dyzet) m²;
- e) në qarkun Korçë, 30 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 818, 36 (tre mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë presje tridhjetë e gjashtë) m²;
- ë) në qarkun Elbasan, 283 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 78 973, 50 (shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre presje pesëdhjetë) m²;
- f) në qarkun Vlorë, 276 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 81 728, 90 (tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e njëzet e tetë presje nëntëdhjetë) m²;
- g) në qarkun Kukës, 50 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 226, 95 (pesë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë presje nëntëdhjetë e pesë) m²;
- gj) në qarkun Dibër, 19 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 166,70 (katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë) m²;
- h) në qarkun Gjirokastrë, 2 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha